



**SMU**

MANUAL – Klasat virtuale (Studenti) – Version 1.0

## Përmbajtja

1	Klasat virtuale.....	1
2	Shkarko materialet mësimore.....	4
3	Syllabusi .....	5
4	Shkarko rezultatet.....	7
5	Lista e figurave .....	9

# 1 Klasat virtuale

Për shkak të gjendjes emergjente të krijuar është zhvilluar moduli i krijimit të klasave virtuale përmes së cilës do të realizohet mësimi online për studentët dhe profesorët, përmes sistemit SMU.

Pasi të jeni qasur në sistemin SMU, klikoni menyën MËSIMI ONLINE => KLASA VIRTUALE ashtu siç shihet në figurën në vijim:




Figura 1: Klasa virtuale

Pas klikimit të kësaj menyje sistemi na e shfaq formën si në figurën në vijim, dhe pas kërkimit përmes fushave kërkuese sistemi na e shfaq listën e klasave virtuale të krijuara për studentët përkatës nga profesorët e lëndve. Ju lutem kërkoni në bazë të dy filterave kërkues Semestri dhe Lënda.





Figura 2: Ligjëratat e krijuara nga profesorët

Nga figura mund të shohim që sistemi na e jep mundësin që të shikojmë në listë të gjitha ligjëratat virtuale të krijuara nga profesorët për studentët që i kanë të regjistruara lëndët tek profesorët përkatës. Nga lista shihet se i kemi dy butona butonin **Detajet** dhe butonin **Lidhu** pas klikimit të butonit **Detajet** sistemi na i shfaq detajet e klasës virtuale përkatëse siç shihet në figurën në vijim:

DATA E FILLIMIT	DATA E MBARIMIT	
20.03.2020 18:15	20.03.2020 21:00	
TEMA		
Ligjerata e pare online		
PËRMBAJTJA E LIGJERATËS		
Ligjerata per pare online ...		
TË GJITHË STUDENTET	STUDENTET PREZENT	AKTIV / PASIV
90	1	



 Anulo

Figura 3: Detajet e klasës virtuale

Butoni **Lidhu** nga Figura 2 është jo-aktiv arsyeja është se ka kaluar koha e mbajtjes së ligjëratave online ose ligjëratat nuk kanë filluar ende (këtë gjë e ka caktuar profesori përkatës kur e ka regjistruar klasën virtuale dhe në momentin që profesori e krijon klasën virtuale sistemi dërgon automatikisht edhe një email në email zyrtar të studentit që na njofton për fillimin e ligjërates virtuale). Forma e email të dërguar është si në figurën e më poshtme.

Përsëritje të nderuar,

Ju njoftojm se në lëndën: GJUHE ANGLEZE I profesori i lëndës  sapo ka filluar ligjëraten online. Ju lutem kyquni në sistem SMU dhe qasuni në ligjerat në mënyrë që të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj. Klikoni në linkun për tu qasur.

[Qasuni në sistem](#)

Stafi ynë ju dëshiron ligjerat të mbarë dhe suksese,

Ky email është i automatizuar, prandaj ju lutem mos u përgjigje

Figura 4: Email i dërguar nga SMU

dhe nëse studenti është brenda intervalit kohor të datës dhe orës së fillimit dhe datës dhe orës së mbarimit të ligjërates atëherë ky link është aktiv dhe mund të klikohet, kjo shihet përmes figurës në vijim:




Figura 5: Kërkimi i klasës virtuale

Nga figura e fundit butonin **Lidhu** e kemi aktiv dhe mund të klikojmë në të, ku pas klikimit në këtë buton sistemi na dërgon te vegla për ndjekje online të ligjëratis nga profesori përkatës. Të njëjtën gjë mund ta bëni edhe duke klikuar tek butoni Copy Link, ku pastaj në një tab të ri e bëni “Paste” likun duke përdorur komandën në tastatur CTRL+V. **Vërejtje** Sistemi SMU e evidenton pjesëmarrjen e studentëve në ligjëratat dhe gjeneron raporte të pjesëmarrjes së studentëve në këto ligjëratat virtuale për profesorët dhe menaxhmentin e Universitetit si dhe **Ligjëratat virtuale janë obligative për studentë.**

Pas klikimit të linku **Lidhu** sistemi SMU ju lidhë direkt me klasën virtuale. Më poshtë e paraqisim formën dhe pas plotësimit me emrin tuaj ose nickname klikoni në butonin “Ask to Join”. **Kujdes** vetëm në këtë mënyrë ju mund ta ndiqni klasën virtuale dhe të evidentoheni si prezent në ligjëratat dhe ushtrimet, të cilat evidencën mund të përdoren më vonë nga profesori i lëndës ose edhe nga menaxhmenti

Sistemi në fillim ju kërkon të ketë qasje në kamerën dhe mikrofonin e pajisjes suaj dhe ju duhet ti jepni qasje duke klikuar butonin “Allow”




Figura 6: Dhënia e lejes për qasje në kamerë dhe mikrofon




Figura 7: Lidhja në klasën virtuale

Pas përcjelljes së këtyre hapve ju bashkoheni në klasen virtuale dhe jeni të detyruar të rri në klasë deri sa profesori i lëndës ta përfundon klasën. Në të kundrën ju largohet pjesmarrja në ligjerata.

## 2 Shkarko materialet mësimore

Shkarko materialet mësimore është nën meny e menysë **Mësimi online** përmes së cilës studentit i listohen materialet dhe mundësia e shkarkimit varësisht nga Semestri, Lënda dhe Lloji i materialit që zgjedhë studenti.




Figura 8: Shkarko materialet mësimore

Pamja e ekranit pasi keni zgjedhur nën meny në Shkarko materialet mësimore duket si në figurën më poshtë:




Figura 9: Kërkimi i materialeve mësimore

Siç vërehet në figurë, për të shfaqur listën e materialeve mësimore studenti duhet të plotësojë fushat

përkatëse, ku duhet të zgjedhë **Vitin akademik, Semestrin, Lëndën** dhe **Lloji materialit** përmes listave rënëse që i shfaqen kur klikon në fushat përkatëse dhe në fund duhet të klikoj butonin **Kërko**. Pastaj studentit do t'i shfaqet në ekran lista e të gjitha materialeve mësimore që i kanë ngarkuar profesorët për atë lëndë dhe semestër përkatës siç vërehet në figurën më poshtë:




Figura 10: Lista e materialeve mësimore

Për të shkarkuar një material mësimor atëherë klikoni në folderin që shihet nga kolona **Më shumë** dhe pas klikimit në këtë ikonë na shfaqet figura në vijim përmes së cilës mund të shkarkojmë materialet mësimore (ligjëratat, ushtrimet ose tjera) të cilat i kanë ngarkuar në sistem profesorët përkatës.




Figura 11: Shkarkimi i materialeve mësimore

### 3 Syllabusi

Syllabusi është nënmeny e menysë Mësimi online përmes së cilës mund të shikohet syllabusi të cilin e ka ngarkuar në sistem profesori përkatës.




Figura 12: Syllabusi

Pas klikimit në këtë meny na shfaqet forma në vijim përmes së cilës bëhet kërkimi i syllabuseve sipas parametrave përkatës të kërkimit.




Figura 13: Lista e syllabuseve

Nga figura e fundit nëse klikojmë te butoni **Detajet** na shfaqet në detaje syllabusi të cilin e ka regjistruar profesori për lëndën përkatëse përmes së cilës studenti gjithashtu edhe mund ti shkarkon nga ky modul bibliografinë e lëndës dhe të gjitha javët të cilat profesori i ka ngarkuar në sistem




Figura 14: Detajet e syllabusit (1)



PARAKUSHTET				
Parakushtet...				
STRATEGJITË				
Strategjiëe...				
PROKOLET E VLERSIMIT				
Protoleë e vlersimii...				
VLERSIMI				
Vlersimii...				
BIBLIOGRAFIA				
LLOJI I MATERIALIT	AUTORI	EMRI MATERIALIT	WEB REFERENCA	SHKARKO
Material Bazikë	Autori Test	Testimm		
PLANI I DETAJZUAR I MËSIMIT PËR NJË SEMESTER				
JAVA	PËRSHKRIMI	EMRI LIGJERATES		SHKARKO
Java 1	Ligjëratat e javës së pare			

Figura 15: Detajet e syllabusit (2)

## 4 Shkarko rezultatet

Shkarko rezultatet është nën meny e menysë **Mësimi online** përmes së cilës studentit i listohen rezultatet varësisht nga afati i zgjedhur dhe i mundësohet shkarkimi i tyre.




Figura 16: Shkarko rezultatet

Pasi të klikoni këtë nën meny atëherë në ekran do j ‘u shfaqet pamja si në figurën më poshtë:

MODULI PËR SHKARKIMIN E REZULTATEVE			
VITI AKADEMIK	AFATI	SEMESTRI	LËNDA
2019/2020	Afati i janarit 2020	Semestri (I)-Ba	GIJHË ANGLEZE I - (1301B01501003)
<input type="button" value="Kërko"/>			

Figura 17: Rezultatet


Siç vërehet në figurë, për të shfaqur listën e rezultateve, studentit duhet të plotësojë fushat përkatëse, ku duhet të zgjedhë **Vitin akademik**, **Afatin**, **Semestrin** dhe **Lëndën** përmes listave rënëse që i shfaqen kur klikon në fushat përkatëse dhe në fund duhet të klikoj butonin **Kërko**. Pastaj studentit do

t'i shfaqet në ekran lista e të gjitha rezultateve që i kanë ngarkuar profesorët për atë lëndë dhe semestër përkatës siç vërehet në figurën më poshtë:

The screenshot shows a web application interface for searching academic results. At the top, there is a search bar titled 'MODULI PËR SHKARKIMIN E REZULTATEVE'. It contains four dropdown menus: 'VITI AKADEMIK' (2019/2020), 'AFATI' (Afati I Janarit 2020), 'SEMESTRI' (Semestri (I)-Ba), and 'LËNDA' (GJUHË ANGLEZE I - (1301B01501003)). A green 'Kërko' button is located below these filters. Below the search bar is a section titled 'LISTA E REZULTATEVE'. It features a table with columns: 'Profesori', 'Viti akademik', 'Përshkrimi', and 'Raporti'. The table contains one row with the following data: 'Laura Naka', '2019/2020', 'Testtttt', and a PDF icon. To the right of the table, there is a 'Kërkoni:' field and a 'Raporti' field. At the bottom right, there are buttons for 'E Kalluara.' and 'Tjetra.' with a page number '1'.

Profesori	Viti akademik	Përshkrimi	Raporti
Laura Naka	2019/2020	Testtttt	

Figura 18: Rezultatet e kërkimi

Për të shkarkuar një rezultat atëherë klikoni në ikonën , ku më pastaj në ekran shfaqet një pdf fajll dhe j'u mundeni të shikoni rezultatet ose të ruani fajllin duke e shkarkuar atë (ruajtja e një pdf fajlli ndryshon varësisht nga shfletuesi që ju përdorni).

## 5 Lista e figurave

Figura 1: Klasa virtuale .....	1
Figura 2: Ligjëratat e krijuara nga profesorët .....	1
Figura 3: Detajet e klasës virtuale .....	2
Figura 4: Email i dërguar nga SMU .....	2
Figura 5: Kërkimi i klasës virtuale .....	3
Figura 6: Dhënja e lejës për qasje në kamerë dhe mikrofon .....	3
Figura 7: Lidhja në klasën virtuale .....	4
Figura 8: Shkarko materialet mësimore .....	4
Figura 9: Kërkimi i materialeve mësimore .....	4
Figura 10: Lista e materialeve mësimore .....	5
Figura 11: Shkarkimi i materialeve mësimore .....	5
Figura 12: Syllabusi .....	6
Figura 13: Lista e syllabuseve .....	6
Figura 14: Detajet e syllabusit (1) .....	6
Figura 15: Detajet e syllabusit (2) .....	7
Figura 16: Shkarko rezultatet .....	7
Figura 17: Rezultatet .....	7
Figura 18: Rezultatet e kërkimi .....	8